

Një prezentim i shkurtë mbi Intervistimin

Përgaditur nga Nicole Farnsworth

Përshkrim i 'Pasur'

- Çelësi për të dhënat kualitative, pasi që mund të jenë më të bindshme se numrat
- Shënim: përshkrimi është ndryshe nga analiza.
 - Shembull: Gruaja fliste shpejt sikurse të ishte në nguti për të përfunduar intervistën. Nën stres, lëvizte lapsin poshtë e lartë duke dëshiruar të ishte diku tjetër.
 - Shembulli 2: The woman talked fast and repeatedly tapped her pencil. Gruaja fliste shpejt dhe pa ndalur lëvizte lapsin poshtë e lartë.
 - Analiza është gjithmonë e nevojshme dhe e rëndësishme, por duhet të dimë dallimin. *Prandaj, gjithmonë vendosni analizën në italics*

Interviewing: Të Reflektuarit

- Intervista është bashkëbisedim mes dy personave: prandaj ne si hulumtues jemi pjesë e krijimit të përgjigjeve
- Gjinia jonë, shprehjet në fytyrë, si vishemi, dhe si i bëjmë pyetjet, të gjitha këto kanë ndikim se çfarë përgjigje marrim ('të reflektuarit'/'reflexivity')
 - Gjinia: Zyrtarë publik flirtues
 - Pyetje të mërzitshme sjellin përgjigje të mërzitshme
 - Pyetje direkte apo indirekte?

Mënyra të Intervistimit

- Ne përdorim 'udhëzues për intervista', që na ndihmojnë për intervista gjysmë të strukturuar
- Është ndryshe anketa apo intervista e strukturuar
- Kemi parë që më shumë merr informata duke pirë një kafe me një person nëpërmjet bashkëbisedimit të thjeshtë se sa duke bërë pyetje specifike nga ndonjë listë

Pyetjet e Mira

Përpilimi i udhëzuesit për intervistë (keni parasysh ‘pyetjet e mira’):

- Pyetje të hapura apo të mbyllura?
- Mundohu t’i mbash të thjeshta dhe të qarta
- Jo të gjata apo komplekse
- Jo të dyfishta me dy kuptime (dy pyetje në të njejtën kohë)
 - Shembull: Si ndiheni për zyrtarët tuaj që janë zgjedhur dhe a keni marrë pjesë në zgjedhje?
- Mos e drejtoni (jepni alternativa)
- Shmangni termet e paqarta (p.sh., komuniteti, zhvillimi, korrupcioni)
- Shmangni termet teknike
- Shmangni termet e ngarkuara (p.sh., demokraci, qeverisje e mirë, liri)
- Shmangni pyetjet me ‘pse’
- Mbani mend që gjithmonë mund të bëni pyetje përcjellëse nëse nuk keni marrë informatat e mjaftueshme ose nëse doni të dini dicka të re; mos hezitoni të pyesni për më shumë detaje

Pyetje në Situata të Ndërlikuara: “A e keni vrarë gruan tuaj?”

(Shembuj nga A.H. Barton, *Survey Research*, Vol. 26, No. 3, 1995, College of Urban Planning and Public Affairs, University of Illinois, Chicago)

- 1) Mënyrë e thjeshtë: “A mos ndoshta e keni vrarë gruan tuaj?”
- 2) Qasje e përgjithshme: “Sic e dini, shumë persona kanë vrarë gratë e tyre kohët e fundit. A mos ndoshta e keni vrarë ju gruan tuaj?”
- 4) “Qasje nëpërmjet të tjerëve”: “A mos e njeh dike që ka vrarë gruan e tij?” (pas përgjigjes) “Po ju?”
- 5) Vendosni pyetjet e ndjeshme në fund të intervistës

Intervista

- Hapja e intervistës
 - Në mënyrë shoqërore, duke u adaptuar me personin që po intervistoni
 - Spjegoni arsyen/qëllimin e intervistës
 - Mos harroni të përmendni se sa do të zgjasë intervista dhe për cilat qështje do të diskutohet
 - Merrni leje për citim direkt (nëse është e pamundur, atëherë në mënyrë anonime)
 - Lejoni personin që po intervistoni të bëjë pyetje rreth hulumtimit/qëllimit të intervistës

Intervista

- Merrni emrin e saktë të personit, si dhe pozitën dhe kontaktet e tjera (këto mund të duhen për pyetje shtesë)
- Të inqizoni apo jo? (Njerëzit kanë tendencë të mos jenë edhe aq të hapur në bisedë kur inqizoni intervistën)
- Marrja e shënimeve:
 - Nuk mund të shkruani secilën fjalë
 - Gjeni shkurtesa të cilat i dini dhe mund t'i shkruani më gjerësisht më vonë
 - Shkruani menjëherë citimet e mira: ‘...’

Intervista

- Gjatë intervistës
 - Dëgjo, mbaj kontakt me sy, bëni komente inkurajuese për të motivuar të intervistuarin të vazhdoj të flas më shumë
 - Tregohuni të ndjeshëm ndaj emocioneve
 - Shmangni urgjencat apo padurimin
- Mbyllja e intervistës
 - Bëni personin të ndihet që intervista shkoi me sukses (p.sh., cekni që kanë dhënë një kontribut shumë të vlefshëm, i cili është shumë i nevojshëm për qëllimin e intervistës)
 - Konfirmo hapat e më tutjeshëm (p.sh., nëse do të ketë ndonjë pyetje shtesë; nëse dëshiron të kontrolloj transkriptën dhe draftin e parë)
- Shikoni shënimet menjëherë pas intervistës për tu siguruar që keni marrë të gjitha informatat dhe të qartësoni pjesët e pakjarta.
- Shkruani transkriptën atë natë, derisa është ende e freskët për ju
- Pas intervistës: shkruani letër/e-mail falendërues